



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 29.10.2013
Nr. 0204-4399

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS, Nr. 015-204629, të pranuar me datën 25.10.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare, Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 015-204629, të miratuar me datë 24.10.2013 nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendim Nr. 015-204629, për plotësimin e vendimit për emërtimin dhe zyrtarizimin e lagjeve, shesheve dhe rrugëve të Komunës së Prishtinës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 29.10.2013
Br. 0204-4399

Za: Isa Mustafa Gradonacelnik Opštine Priština
Sami Hamiti, Predsedavajući Skupštine Opštine Priština

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE PRIŠTINA,
Br. 015-204629, primljeno dana 25.10.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu br. 03/L-144, dodatak XII Uredbe Vlade br. 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja odluke br. 015-204629, usvojene dana 24.10.2013 od Skupštine Opštine Priština, **POTVRDJUJE** zakonitost akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.

Pravni Akt koji ima puni pravni efekat:

- Odluka Br.015-204629 za dopunu odluke za imenovanje i ozvaničenje naselja, trgova i ulica Opštine Priština.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik Premijera & Ministar MALS,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 17, pika o dhe neni 40, paragrafi 40.2, pika i, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008") dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika i e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.10.2013, merr këtë

V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR EMËRTIMIN DHE ZYRTARIZIMIN E LAGJEVE, SHESHEVE DHE RRUGËVE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

I.

Miratohet Vendimi për plotësimin e Vendimit për emërtimin dhe zyrtarizimin e lagjeve, shesheve dhe rrugëve të komunës së Prishtinës, 01. nr. 015 - 719, të dt. 16.5.2001.

II.

Në vendimin e cekur në pikën I. të këtij vendimi, te pjesa përbërëse e rrugëve, lista plotësohet me emërtimin e këtyre rrugëve.

III.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë ekstraktet e mbledhjeve të Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike të komunës së Prishtinës, me emrat e propozuar të rrugëve të reja, mbajtur më 14 - 15.8.2013.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

V.

Ky vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 nr.015-204629, më 24.10.2013



KRYESUESI I KUVENDIT

Samir Hamiti, ecc.i d/pl.